

**Dr. Vehbetu Zuhejli**

# **Objektivat e sheriatit**

XVI

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:

**Dr. Vehbetu Zuhejli**

Përktheu:

**Dr. Musli Vërbani**

Titulli:

**Objektivat e shariatit**

Korrektura:

**Burim Bunjaku**

*Të drejtën e ribotimit e rezervon autori*



## **Objektivat e shariatit**

- **definicioni,**
- **rëndësia,**
- **shariati ndërtohet mbi bazat e interesit,**
- **kushtet të cilat llogariten si objektiv,**
- **llojet e objektivave të cilat sjellin rezultate në shoqëri,**
- **mjetet plotësuese,**
- **renditjet (kategoritë),**
- **llojet e interesave në bazë të nevojave,**
- **llojet e interesave shoqërore dhe individuale.**

## **E para: Definicioni i objektivave të shariatit dhe rëndësia e saj dhe ndërtimi i shariatit mbi parimin e interesit**

**Objektivat e shariatit janë koncept dhe qëllime të cilat Ligjvënësi i parasheh të të gjitha ligjet ose në të shumtën e tyre, ose është pikësynim i shariatit, dhe janë sekretet të cilat i ka vendosur Ligjvënësi në secilin ligj prej ligjeve.** Mësimi i saj është çështje e domosdoshme në çdo kohë për të gjithë njerëzimin, për muxhtehidin të cilit i nevojitet për të përpiluar ligje dhe për t'i kuptuar tekstet, ndërsa për jomuxhtehidin që të mësoj sekretet e ligjësimit.

Nëse një muxhtehidë dëshiron të di për ligjin e një ndodhie, ai ka nevojë që t'i kuptoj tekstet që më pastaj t'i zbatoj te ngjarjet.

Nëse dëshiron harmonizimin e argumenteve kundërthënëse ai mbështetet në objektivat e shariatit.

Nëse e kërkon nevoja për të sqaruar ligjin e Allahut për një çështje të rezultuar nëpërmjet rrugës së kijasit apo parimit të interesit apo të istihsanit e të ngjashme, me precizitet proceson pikësynimet e shariatit.

Është vërtetuar se shiariati është themeluar për të siguruar interesin e njerëzimit herët a vonë ose për t'ua larguar atyre dëmin, ose për t'u sjell dobi, siç e dëshmojnë faktet në vazhdimësi nëse përcillen dhe monitorohen ligjet<sup>1</sup> dhe nëse e vërejmë se kah udhëzojnë tekstet e shariatit nga këndvështrimi parimor siç është p.sh. ajeti kur'anor:

رُسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ

**“të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të kenë fakt (arsyetim) para All-llahut.(En-Nisa : 165)**

Dhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

**“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (El-Enbija : 107)**

Po ashtu vërtetojnë sqarimet e ligjeve parciale. Për shembull Zoti i Lartmadhëruar për abdesin thotë:

مَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيَجْعَلَ عَلَيْكُمْ مِّنْ حَرَجٍ وَلَكِنْ يُرِيدُ لِيُطَهِّرَكُمْ وَلِيُتِمَّ نِعْمَتَهُ  
عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

**“All-llahu nuk dëshiron (me obligim për abdes e larje) t’iu sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastroj dhe të plotësoj të mirën e Tij ndaj jush e që t’i falënderoheni.” (El-Maide : 6)**

Për agjërimin Zoti i Lartmadhëruar thotë:

كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِنَ الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

**“Agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare : 183)**

Për namazin Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ

**“Vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe irritueset.” (El-Ankebut : 45)**

Për drejtimin e kibles, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَوَلُّوا وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَيْكُمْ حُجَّةٌ

**“Ktheni fytyrat tuaja kah ana e saj, ashtu që njerëzit mos të kenë argument kundër jush.” (El-Bekare : 150)**

Zoti i Lartmadhëruar për xhihadin thotë:

ثُمَّ لِيَقْضُوا تَفَثَهُمْ وَلِيُوفُوا نُدُورَهُمْ وَلِيَطَّوَّفُوا بِالْبَيْتِ الْعَتِيقِ

**“Pastaj le të heqin papastërtinë e tyre, le t’i zbatojnë premtimet e veta dhe le të sillen (bëjnë tavaf) rreth shtëpisë së lashtë.” (El Haxh : 29)**

Për hakmarrjen:

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيَاةٌ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

**“O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri tjetrit).” (El-Bekare : 179)**

Për deklarinimin e njëshmërisë së Allahut, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ ۖ قَالُوا بَلَىٰ ۗ شَهِدْنَا ۗ أَنْ تَقُولُوا يَوْمَ الْقِيَامَةِ إِنَّا كُنَّا  
عَنْ هَذَا غَافِلِينَ

**“dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre (duke u thënë): -A nuk jam Zoti juaj? Ata thanë: -Po, dëshmuam! Të mos thoni në ditën e kijametit: -Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur.” (El-Earaf : 172)**

Shitblerja është lejuar për të siguruar interesat e robërve, plotësimin e nevojave të tyre.

E ka ndaluar gjykimin në gjendje hidhërimi, këtë e ka bërë sepse në atë rast gjykimi sjell dëm dhe paqartësi sepse mendja është jashtë kontrollit.

Prostitucioni është haram dhe e keqe sepse sjell shkatërrim nëpërmjet përzjerjes së farës dhe pasardhësve, dhe shkakton armiqësi dhe urrejtje në mes të njerëzve.

Kështu, nga secili ligj gjenden tri çështje:

**E para:** atributi i qartë dhe i saktë, si f.v., shitblerja, urrejtja dhe prostitucioni, e ajo është arsyeja.

**E dyta:** Çka gjendet në veprën, prej dëmit apo dobisë dhe kjo varet në atë se a sjell dobi apo dëme, ose urtësia e ligjësimit.

**E treta:** Çka rezulton prej ligjësimit prej realizimit të dobive apo largimin e dëmit, e cila quhet objektiv i shariatit.

Kjo është specifike kryesore e çdo ligji të shariatit.

Çdo ligj vendoset ose për të siguruar interesin ose për të larguar dëmin, dhe për çlirimin e botës nga të këqijat dhe mëkatet, gjë që tregon se shiati pikësynon realizimin e qëllimit të përgjithshëm dhe lumturinë e individit dhe të shoqërisë dhe sigurimin e sistemit, zhvillimin e kësaj jete me çdo gjë që ndërlihet me shiatiin e deri në nivelet më të larta, dhe plotësimin e të gjitha të mirave të njerëzimit.

Në tërësi, ligjësimi sjell interes, dhe çka kërkon Ligjvënësi është që të realizohet e mira herët a vonë, ndërsa çdo gjë që ndalon, përfshinë largimin e dëmeve dhe shkatërrimin.



## **E dyta: Kushtet të cilat burojnë nga opinionet (e dijetarëve)**

Për t'u konsideruar objektivi legjitim, kushtëzohet që objektivi të jetë:

- i qëndrueshëm,
- i qartë,
- i saktë dhe
- i rregullt.<sup>2</sup>

Me fjalën i **“qëndrueshëm”** qëllimi është që kuptimet e saj të jenë të prera në realizim ose i përafërt me qëndrimin e prerë, pra që të paramendohet realizimi.

Qëllimi me fjalën **“i qartë”** është kthjelltësia, deri në atë masë sa fukahatë të mos kenë kundërshtime në diagnostifikimin e saj si p.sh., sigurimi i pasardhësve për të cilin qëllim është ligjësuar kurorëzimi. Kjo është e qartë, nuk ka kurrfarë mjegullie, sikurse ajo që arrihet me kujdestari, ose që femra ligjet dhe mbetet shtatzënë me një njeri të caktuar me të cilin ka jetuar.

Qëllimi me fjalën **“i saktë”**. Që të ketë kuptim jo të dyshimtë, ashtu që as të mos jetë i mangët dhe as i tepërt. Shembull: Sigurimi i mendjes, që për t'u siguruar është ndaluar alkooli dhe ligjësimi i dënimit, për arsye se e largon logjikën nga njerëzit e logjikshëm.

Me fjalën **“i rregullt”**, qëllimi është që të mos ketë kuptim i cili ndryshon me ndryshimin e kohëve dhe të vendeve si p.sh., sipas Malikijëve, atributi që *të jetë i fesë islame* dhe *aftësia për t'u kujdesur* janë kushte prej kushteve të kurorëzimit.

Kur të realizohen kuptimet e këtyre kushteve, atëherë bindemi se ato janë opinione të shariatit dhe atëherë nuk ka arsye të konsiderohen iluzione dhe paragjykime dhe nuk mbetet alternativë përpos që të llogariten objektiv i shariatit.

Sa i përket **“iluzionit”**, janë ide të cilat i shpikin njerëzit të cilat nuk kanë kurrfarë efekti që të prodhojnë një fakt në aspektin e jashtëm, si f.v., iluzioni se te i vdekuri ka diçka dhe më pastaj vjen deri te frika prej kufomës ose iket prej të vdekurit kur është në vetmi me të.

Sa i përket **“paragjykimeve”**, janë ide të cilat i mendojnë njerëzit dhe i paraqesin në çështje konkrete, si f.v., paraqitja e personave në formë të lisave, e të ngjashme.

Iluzionet dhe paragjykimet nuk lejohet të jenë opinione të shariatit, shembull, shpallja e pavlefshme e adoptimit e cila ka qenë praktikë e kohës së injorancës para islamike, pasi kjo çështje ka qenë çështje iluzionare ose, ligji se agjëruesi nuk do ta prish agjërimin sepse ka humbur ndokush, sepse e paragjykon se e han mishin e vëllait të vet, dhe iluzioni se nuk lejohet të hipet në deve gjatë haxhit.

Në librin “Muvetaë” është regjistruar se pejgamberi s.a.v.s. e ka parë një njeri duke e tërhequr pas vete një deve. ***Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: -Hip.***

***Ai i thotë: - O i dërguar i Allahut, ajo është deve.***

***Pejgamberi s.a.v.s i thotë: -I mjeri ti, po hip në deve.***

## **E treta: Llojet e interesave varësisht prej ndikimit të tyre në shoqëri**

Na u bë e qartë se objektivi i shariatit në ligjësim është sigurimi i shoqërisë mbarë botërore dhe kanalizimi i veprimeve të njerëzve në atë mënyrë që të mos lejohen të shkatërrohen. Kjo arrihet ose duke realizuar interesat ose duke e bërë largimin e dëmit. Pra, varësisht prej ndikimit të tyre në shoqëri dhe në individë.

### **Cilat janë llojet e interesave?**

Interesat varësisht prej forcës së tyre dhe ndikimit të tyre ndahen në tri lloje:<sup>3</sup>

## 1. Domosdoshmëritë

Interesat e domosdoshme janë interesa prej të cilave varet jeta e njerëzve në këtë botë dhe në botën tjetër, ashtu që nëse mungojnë, paralelizohet jeta në këtë botë dhe fillon shkatërrimi, humb e mira dhe begatia, dhe fitohet ndëshkimi në botën tjetër.

Këto domosdoshmëri janë pesë: sigurimi i fesë, identitetit, mendjes, pasardhësve dhe pasurisë. Këto janë kategoria më e fuqishme e interesave.

Mbi ta bazohet çështja e fesë dhe e kësaj bote, duke i siguruar ato garantohet çështja e shoqërisë dhe individit dhe me sigurimin e këtyre domosdoshmërive garantohet siguria. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا جَاءَكَ الْمُؤْمِنَاتُ يُبَايِعَنَّكَ عَلَىٰ أَنْ لَا يُشْرِكَنَّ بِاللَّهِ  
شَيْئًا وَلَا يَسْرِقَنَّ وَلَا يَزْنِينَ وَلَا يَقْتُلَنَّ أَوْلَادَهُنَّ وَلَا يَأْتِينَ بِبُهْتَانٍ يَفْتَرِينَهُ بَيْنَ  
أَيْدِيهِنَّ وَأَرْجُلِهِنَّ وَلَا يَعْصِيَنَّكَ فِي مَعْرُوفٍ ۗ فَبَايِعْنَهُنَّ وَاسْتَغْفِرْ لَهُنَّ  
اللَّهُ ۗ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“O Pejgamber, kur të vijnë besimtares që të japin besën se: nuk do t’i shoqërojnë asnjë send All-llahut; se nuk do të vjedhin; se nuk do të bëjnë kurvëri; se nuk do t’i mbysin fëmijët e tyre; se nuk do të gënjejnë me ndonjë shpifje për (fëmijën e huaj që kanë marrë) se është i tyre; dhe se nuk do të të kundërshtojnë në atë që i urdhëron, atëherë, prano zotimin e tyre dhe lute All-llahun t’i falë ato, se All-llahu është mëkatfalës dhe mëshirues.” (El-Mumtehine : 12)

Kjo çështje nuk ka të bëjë vetëm për gratë apo besimtares siç vërtetohet në Sahihun e Buhariut.

Ligji, këto domosdoshmëri i siguron në dy aspekte:

- **aspekti i parë: ekzistimin dhe realizimin e tyre,**
- **aspekti i dytë: vazhdimësia.**

**Aspekti i parë:** Pozitiviteti i cili lidhet me përkujdesjen e tyre (domosdoshmërive), nga fakti se ekzistojnë.

**Aspekti i dytë:** Negativiteti, e cila ndërlidhet me mospërkujdesjen e tyre, siç ka thënë Shatibiu.

**Feja dhe ekzistimi i saj:** Zoti i Lartmadhëruar ka obliguar zbatimin e pesë shtyllave të islamit (adhurim dhe besim) dhe për të siguruar këtë çështje e ka ligjësuar xhihadin dhe ndëshkimin e atij i cili e paralizon duke tradhtuar. Duke plotësuar këtë domosdoshmëri duhet siguruar parimin e devotshmërisë dhe ruajtjen e çdo muslimani nga vetshkatërimi.

**Sigurimin e jetës:** Zoti i Lartmadhëruar ka ligjësuar martesën, për të vazhduar kontinuiteti i llojit njeri me lindje të fëmijëve dhe me mbrojtjen e tyre. Zoti i Lartmadhëruar i ka paraparë domosdoshmëritë e ushqimit, pijes dhe veshmbathjes. Ka paraparë dënimin për vrasësin duke filluar prej hakmarrjes, DIJES dhe kompensimit. Me këtë mbrohet jeta dhe njerëzit.

**Sigurimi i mendjes:** Zoti i Lartmadhëruar ia ka dhuruar mendjen njeriut, Zoti i Lartmadhëruar ka lejuar çdo gjë që i shërben mendjes, si me zhvillimin edukativ ashtu edhe arsimor dhe shkencor, dhe fuqinë e tij, dhe ka ndaluar veprimet si f.v., pirjen e pijeve alkoolike dhe narkotike dhe ka paraparë dënim të caktuar kush i përdor pasi kështu garantohet mendja e cila është kandar i kryerjes së detyrave dhe obligimeve.

**Sigurimi i gjenit dhe nderit:** Është ligjësuar martesë, ndërsa (Ligjvënësi) ka ndaluar shpifjen dhe prostitucionin, dhe ka paraparë masa ndëshkuese për ta siguruar atë (familjen) dhe kjo garanton mospërzierjen e farës<sup>4</sup> dhe kontinuitetin e llojit njeri.

**Sigurimi i Pasurisë:** Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë që të jetë obligim angazhimi për të siguruar furnizimin. I ka ligjësuar veprimtaritë reciproke në mes njerëzve duke filluar nga shitblerja, dhuratat, qiradhëniet, shoqëritë aksionare, huazimet, etj.

Për t'u siguruar pasuria, është ndaluar vjedhja dhe e ka paraparë ndëshkimin me prerje të dorës për vjedhësin dhe vjedhësen.

E ka ndaluar mashtrimin, tradhtinë, kamatën dhe ngrënien e pasurisë së njëri-tjetrit me padrejtësi. I ka paraparë garancionet në rast të prishjes së mallit pasi me këtë e mbron pasurinë e cila është e domosdoshme për njerëzit.

## 2. Nevojat

Janë nevojat për të cilat kanë nevojë njerëzit në mënyrë që të kenë lehtësime dhe për largimin e vështirësisë, por mungesa e tyre nuk shkakton paralizimin e sistemit jetësor sikurse është rasti me domosdoshmëritë, por pasohet vuajtja dhe vështirësia, andaj nevojat vijnë pas domosdoshmërive. Të gjitha ligjësimet e shariatit përfshihen brenda kornizës së largimit të vështirësisë në mënyrë që njerëzve t'u lehtësohet jetesa.

**Në adhurime:** është ligjësuar lehtësimi me shkurtim të namazit dhe bashkim të tyre për udhëtarët. Lejimi i mosagjërimit të muajit ramazan për të sëmurin dhe udhëtarin. Falja e namazit ulur për atë i cili nuk mund të falet natën (namaz nate). Lirimi total nga namazi për lehonën dhe gruan me menstruacion. Mes'hin mbi meste për rezidentin dhe për udhëtarin, e të ngjashme.

**Në zakone:** e ka lejuar gjuetinë dhe shfrytëzimin e të mirave për furnizim për ngrënie, pirje, veshmbathje dhe vendbanim.

**Në marrëdhënie reciproke:** janë lejuar kontratat të cilat plotësojnë nevojat e njerëzve, duke filluar nga kontratat e shitblerjes, kontratat e qiradhënieve, shoqëritë aksionare, garancionet, donacionet, siç janë lejuar rrugët e kryerjes së obligimeve, po ashtu është bërë lejimi nga detyrimet me prishje të kontratës dhe rastet përjashtuese dhe përfundimin e martesës me shkurorëzim në rast nevoje apo domosdoshmërie, autorizimin e kujdestarit për kurorëzim nga ana e vajzës për shkak se ajo ka nevojë të martohet me bashkëshort të përshtatshëm për të, e të ngjashme.

**Në vepra penale:** ka ligjësuar kujdestarin të falë në vend se të hakmerret, që familjarët të kenë të drejtë të marrin DIJEN dhe mosekzistimin e dënimeve të rënda nëse ekziston dyshimi, e të ngjashme.

### 3. Plotësimet apo komoditetet

Janë interesa që sjellin harmoni dhe me to pikësynohet që të veprohet me metodat zakonore dhe veprimet fisnikëruese, por nëse mungojnë nuk kanoset rreziku sikurse te domosdoshmëritë dhe nuk kanë të bëjnë me lehtësimin sikurse me rastin e nevojave, mirëpo nga këndvështrimi i të logjikshmëve jeta nuk është komode por është e vështirë.

Këto bëjnë pjesë në kategorinë e tretë dhe përfshihen në adhurime, zakone, në marrëdhënie reciproke dhe në vepra penale.

**Në adhurime:** janë ligjësuar pastrimet dhe mbulimi i trupit në namaz. Veshja e mirë dhe qëndrimi i mirë, dhe zbukurimi para çdo shkuarje në xhami apo në ndonjë vendtubim. Po ashtu edhe afrimi tek Allahu me llojet e adhurimeve si me namaze, agjërim dhe sadaka.

**Në marrëdhëniet reciproke:** ka ligjësuar ndalimin e blerjeve të sendeve të dëmshme dhe jo të pastra, ka ndaluar pengimin e ujit tepricë dhe kullosën tepricë. Po ashtu ka ndaluar blerjen e sendit të cilin është duke e blerë vëllai, ka ndaluar fejesën me të fejuarën e vëllait. Në jetën bashkëshortore, ka urdhëruar jetesën me butësi dhe bamirësi. Dhe që aktin (e kurorëzimit) e femrës mund ta kryej kujdestari – përpos te fukahatë Hanefijë – për shkak të turpërimit, pasi gruaja zakonisht turpërohet që ta kryej aktin e kurorëzimit, ashtu siç ka urdhëruar të dëshmojnë dëshmitarët në kurorëzim që të ngrihet vlera e kurorëzimit, e raste tjera të ngjashme.

**Në veprat penale:** në luftë, ka ndaluar masakrimin, vrasjen e grave, fëmijëve dhe priftërinjve. Ka obliguar kryerjen e premtimeve. Ka ndaluar mashtrimin. Prej çështjeve të pëlqyera është edhe moslejimi i i paraqitjes së ngatërresave dhe mospjesmarrja në ngatërresa. Kjo është më e mirë se sa të jesh pjesë e ngatërresave dhe shkatërrimit.



#### 4. Plotësimi i interesave të mëparshme

Zoti i Lartmadhëruar ka ligjësuar ligje tjera që t'i plotësoj llojet e objektivave të mëparshme të domosdoshmërive, nevojave dhe zbukurimeve, si plotësim të tyre dhe të cilat në esencë poqëse mungojnë nuk lënë mangët ndonjë send.<sup>5</sup>

**Plotësimi i domosdoshmërive:** e ka paraparë barazinë në realizimin e hakmarrjes e kjo është paraparë që të jetë ndëshkim dhe shërim, e dihet që kjo nuk arrihet përpos me barazi të plotë. Ky është plotësim për sigurinë e jetëve.

Po ashtu ndalimi i pirjes së paktë të alkoolit sepse shpie në pirje të shumtë, pastaj edhe analogohet me çdo pije dehëse, e kjo për të plotësuar sigurinë e mendjes.

Pastaj, ndalimi i shikimit të gruas së huaj (përpos me ato me të cilat të ndalohet martesja) dhe vetmimi me to, si masë parandaluese e cila ndalon prostitucionin. Kjo është plotësim i domosdoshmërisë për të siguruar pasardhësit duke e ndaluar prostitucionin.

Po ashtu, ligjësimi i ezanit dhe falja e namazit me xhematë, që të jetë si bazë e forcimit të fesë, që të plotësohet duke treguar simbolet dhe bashkimin.

Dhe për të pasur kujdes në dënime që të mos dëmtohet tepër pasuria e tjetrit, por kthimi i investimit të jetë në të njëjtën masë, siç është paraparë me rastin e prishjes së kontratës. Këto tre shembuj janë si plotësim i domosdoshmërisë së pasurisë së dy palëve. Po ashtu është ndaluar kamata si plotësim për sigurimin e pasurisë sepse pjesa shtesë e cila paguhet nga borxhmarrësi është shkapërderdhje pa nevojë, e cila është në kundërshtim me atë të cilin e parasheh ligji.

**Plotësimi i nevojave:** shembull, kushtëzimi që bashkëshortët të jenë të përshtatshëm për njëri-tjetrin, që të realizohet harmonia në mes tyre vajza e re martohet vetëm me të përshtatshëm dhe me mehrin e ngjashëm (të moshatareve të saja) sepse kjo është baza kryesore e cila pikësynohet me kurorëzim, edhe pse mund të ndodhë pa to, mirëpo ato e realizojnë kontinuitetin e martesës sepse nuk mund të vazhdoj jeta konstante pa plotësimin e nevojave të martesës e vajzës së re.

Kur Zoti i Lartmadhëruar i ka ligjësuar llojet e veprimeve të marrëdhënieve njerëzore mes vete si shitblerjen, qiradhënien, shoqëritë aksionare, etj., ka ligjësuar ligjet plotësuese për të ndaluar mashtrimet, ka ndaluar shitblerjen inekzistente, ka ndaluar shitblerjen e mallit pa i ditur karakteristikat e saj, prej atyre plotësimeve janë e drejta e zgjedhjes pasi që blerësi ta teston mallin, e drejta e zgjedhjes së kushtit për dy kontraktuesit, e kushtëzimi i kushteve në kontrata është bërë për t'i plotësuar nevojat e njerëzve për të mos lejuar krijimin e urrejtjeve dhe armiqësive.

Kur Ligjvënësi e ka lejuar shkurtimin e namazit gjatë udhëtimit, e ka plotësuar duke lejuar bashkimin e namazit përpos namazit të sabahut (nuk lejohet të bashkohet).

Kur Ligjvënësi ka ligjësuar tregtinë, e ka plotësuar duke e ndaluar lajkatimin, mashtrimin dhe tradhtinë, e të ngjashme.

Kur Ligjvënësi e ka lejuar shitblerjen, e ka plotësuar që të bëhet me dëshmitarë (kur jepet borxhi) me lënie peng dhe me autorizim.

Po të mos ishin ligjësuar këto ligje, në esencë nuk do të lejoheshin, por janë ligjësuar për lehtësim dhe tolerancë.

**Plotësimi i zbukurimeve:** si, rregullat e kryerjes së nevojës dhe çështjet e pëlqyera në pastërti dhe mosprishja e adhurimeve të cilat kanë filluar me ta. Pastaj, shpenzimi nga të mirat dhe fitimet në aktivitetet vullnetare dhe të lëmshave. Përzgjedhja e kurbaneve sa më të mirë dhe “akikit” sa më të mirë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَلَا تَيَمَّمُوا الْخَبِيثَ مِنْهُ تُنْفِقُونَ وَلَسْتُمْ بِآخِذِيهِ إِلَّا أَنْ تُغْمِضُوا فِيهِ ۗ  
وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ حَمِيدٌ

**“E mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete pos symbyllas. Dhe dijeni se All-llahu nuk ka nevojë për ju, ngase është i Madhëruar.” (El-Bekare : 267)**

**Nevojat janë plotësim i domosdoshmërive.**

**Zbukurimet janë plotësim i nevojave.**

**Pa kurrfarë dyshimi se domosdoshmëritë janë baza e interesave.**

## Renditja e objektivave

Kjo përmban dy çështje:

**E para: Tri kategoritë e objektivave të shariatit nuk janë të pavarura nga njëra-tjetra, por janë plotësim i njëra-tjetrës.**

Mirëpo **domosdoshmëritë** janë bazë e të gjitha objektivave të shariatit. Ato janë bazë edhe e nevojave edhe e zburimeve.<sup>6</sup> Kush e paralizon themelin, automatikisht i ka paralizuar edhe tjerat sepse ato (domosdoshmëritë) janë si farzet, ndërsa nevojat janë sikurse nafilet, përderisa zburimet janë sikurse çështjet e rëndësishme të cilat nuk janë nafile.

Sa i përket nevojave dhe zburimeve, ato janë për të mos lejuar rrënimin e domosdoshmërive. Ato janë si mbrojtës rreth greminës që nuk lejojnë rënie në greminë, kështu që nevojat dhe zburimet e luajnë rolin e mbrojtësit të domosdoshmërive, me një fjalë janë lloj prej llojeve të mbrojtësit të domosdoshmërive.

Nga kjo kuptohet se, domosdoshmëritë janë më të rëndësishme se nevojat (nevojshmëritë) sepse mbi to qëndron ekzistenca e jetës dhe me mungesën e tyre paralizohet jeta. Përderisa në mungesë të nevojave rezulton vuajtje, ngushtim dhe vështirësim të jetës por nuk kemi paralizim të sistemit të jetës.

Sa i përket zburimeve, me mungesën e tyre nuk rezulton paralizimi i sistemit të jetës dhe as nuk kemi rënie në pozitë të vështirë dhe në vuajtje, por rezulton mosngritja në programin e përsosmërisë jetësore.

Në bazë të kësaj, ligjet e shariatit për sigurimin e *domosdoshmërive* janë ligjet më të rëndësishme, pastaj pasojnë ligjet e *nevojave*, sepse ato i plotësojnë domosdoshmëritë, pastaj ligjet e *zburimeve* sepse ato i plotësojnë nevojat. Baza ka prioritet ndaj plotësueses, nuk kemi për qëllim plotësimin e cila ka përparësi ndaj nevojave dhe zburimeve sepse domosdoshmëria mund të asimilohet me asimilimin e plotësimeve të tyre, për këtë arsye kërkohet që të kujdeset dhe të ruhen ato. Nga këtu, kategoria e domosdoshmërive është pjesë e çdo populli, saqë për to nuk kanë

mospajtime popujt, ashtu siç kanë mospajtime në çështjet sekondare, siç ka thënë Shatibiu: *“Ato (objektivat) janë bazat e fesë, rregullat e sheriatit dhe çështjet e përgjithshme të popujve”*.

a. Nga kjo rezulton se: nuk merret parasysh ligji i zbukurimeve nëse duke u përkujdesur për to vjen deri te dëmtimi i ligjeve të nevojave dhe domosdoshmërive, si p.sh., lejohet zbulimi i organeve në raste nevojë ose domosdoshmërie, në rast operacioni apo kontrollimi mjekësor për sëmundje dhe për shërim të sëmundjeve sepse për të siguruar shëndetin është domosdoshmëri dhe mbulimi i organit intim është prej zbukurimeve dhe as që merret parasysh kur të jetë në pyetje nevoja apo domosdoshmëria, sepse sigurimi i jetës është domosdoshmëri. Mënjanimi i ushqimeve të përbuzura ose ndalimi i mishit të cofëtinës janë prej zbukurimeve.

Është lejuar shitblerja inekzistente në aktin e blerjes së mallit me porosi, ose me huazim dhe paradhënie të prodhimit industrial dhe merret parasysh kontrata në agronomi edhe nëse nuk dihet sasia e cila do të prodhohet. Është lejuar shitblerja e sendit joprezent sepse prezenca e mallit dhe njohuria e sasisë janë prej zbukurimeve. Dhe këto veprimtari janë veprimtari të nevojave, nëse mungojnë vështirësohet gjendja e njerëzve, kështu anashkalohen ligjet e zbukurimeve në barrë të realizimit të nevojave.

b. Po ashtu, nuk merret parasysh ligji i nevojës nëse e paralizon ligjin e domosdoshmërisë sepse largimi i vështirësisë është nevojë, ndërsa kryerja e farzit është domosdoshmëri. Prej të ngarkuarve kërkohet kryerja e farzeve, edhe pse sjellin një lloj vështirësie ato janë obligime sepse farzi është prej domosdoshmërive. Largimi i vështirësive është prej nevojave. Namazi është domosdoshmëri, të drejtuarit në drejtim të Qabes është nevojë e cila plotëson domosdoshmërinë. Nuk është e drejtë (nuk lejohet) që falësi i cili është i sigurt se në cilin drejtim është Qabeja të falet në drejtimin tjetër, ndërsa nëse nuk është i sigurt se në cilin drejtim është Qabja, mjafton dhe i lejohet.

**E dyta: Në sferën e domosdoshmërive merret parasysh cila është më e rëndësishme se tjetra sepse kjo është në sferën çështjes së plotësimeve.**

Nuk sigurohet çështja e cila e shkatërron një çështje më të rëndësishme. Xhihadi, edhe pse shpie në humbjen e jetës e kështu cenohet sigurimi i jetës e cila është çështje domosdoshmërie, prapëseprapë ajo shkrihet në rrugën për të mbrojtur fenë, dhe nëse na sulmojnë armiqtë, dhe në këtë rast është obligim t'i luftojmë ata në mënyrë që të mbrojmë fenë sepse sigurimi i fesë është më i rëndësishëm, dhe kështu rrëzojmë ligjin e sigurimit të jetës për të siguruar fenë.

Lejohet pirja e alkoolit në rast dhune apo domosdoshmërie me qëllim që të sigurohet jeta sepse sigurimi i jetës është më i rëndësishëm se sigurimi i mendjes.

Lejohet dëmtimi i mallit të tjetrit nëse njeriu kërcënohet për ta dëmtuar sepse sigurimi i jetës ka përparësi ndaj sigurimit të pasurisë.

Renditja e rëndësisë së domosdoshmërive, apo pesë çështjeve vitale janë si në vijim:

- sigurimi i fesë,
- sigurimi i jetës,
- sigurimi i mendjes,
- sigurimi i pasardhësve,
- sigurimi i pasurisë.

Disa prej dijetarëve të usulit, si Gazaliu, i japin përparësi pasardhësve ndaj pasurisë.

Disa dijetarë tjerë të usulit si Gazaliu i japin përparësi gjenit para mendjes.

**E treta: Llojet e objektivave (interesave) varësisht atij kolektiv apo individual.**

Në bazë të këtij kandari, interesat ndahen në:

- të përgjithshme,
- të veçanta.<sup>7</sup>

**Interesa të përgjithshme**, janë interesat të cilat kanë të bëjnë për të gjithë umetin, apo e mira dhe dobia e pjesës më të madhe të shoqërisë.

Shembull: Mbrojtja e vendeve nga armiku, mbrojtja e përçarjes së umetit, moslejimi i zhdukjes së fesë.

Ruajtja e Kur'anit nga faktorët të cilët dëshirojnë ta dëmtojnë. Mbrojtja e sunetit nga hadithet e shpikura. Ruajtja e dy vendeve të shenjta, Mekes dhe Medines, që të mos bien në duar të armikut.

**Interesi i veçantë**, është interesi individual ose i një grupi të vogël të individëve, si f.v., ligjësimi i marrëdhënieve reciproke.

**E katërta: Llojet e objektivave (interesave) varësisht prej nevojës.**

Varësisht prej nevojës së sjelljes së dobisë dhe largimit të dëmit, interesat ndahen në:

- Interes i sigurt,
- Interes jo i sigurt dhe
- Interes iluzionar.<sup>8</sup>

**Interes i sigurt:** Është interesi të cilin e tregon teksti në mënyrë të prerë, i cili tekst nuk lejon alternativë tjetër.

Shembull:

فِيهِ آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ مِّمَّا مَكَرَ الْكٰفِرِيْنَ ۗ وَمَنْ دَخَلَهُ كَانَ آمِنًا ۗ وَلِلّٰهِ عَلَى  
النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ اِلَيْهِ سَبِيْلًا ۗ وَمَنْ كَفَرَ فَاِنَّ اللّٰهَ غَنِيٌّ عَنِ  
الْعٰلَمِيْنَ

**“Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit, dhe kush hyn në te, ai i sigurt. Për hir të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All-llahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit.” (Ali Imranë : 97)**

Ose që e tregojnë argumentet e shumta në mënyrë të vazhdueshme dhe e mbështesin atë interes, siç janë pesë domosdoshmëritë apo pesë çështjet vitale të përmendura më parë ose ai interes që mendja (logjika) e dëshmon që me të realizohet dobi e madhe, ndërsa e kundërta (mosrealizimi) sjell dëme të mëdha, si f.v., luftimi i penguesve të zekatit, në kohën e Ebu Bekri Siddikit.

**Interesat jo të sigurta,** janë to për të cilat mendja logjikon se janë interes, si f.v., mbajtja e qenve rojtar para shtëpisë për mbrojtje të shtëpisë, ose ato që vijnë me argument jo të prerë nga Ligjvënësi, shembull, hadithi: *Gjykatësi nuk gjykon kur të jetë në gjendje hidhërimi.*<sup>9</sup>



**Interesat iluzionare**, janë ide iluzionare për të cilat mendohet se sjellin të mira dhe dobi, ndërsa në të vërtetë sjellin dëm, si f.v., përdorimi i mjeteve narkotike si afioni, kokaina, heroina dhe kanabisi, dhe pirja e pijeve dehëse, siç janë pijet alkoolike dhe pijet tjera dehëse. Përdoruesi krijon opinion se është në dobi të tij, mirëpo dëmi është faktik dhe shkatërrimi është i sigurt, e dëmtojnë trupin, i plogështojnë eshtrat dhe shpijnë në paaftësi dhe paralizim, dhe veprimtaritë e njeriut në gjëra të tilla umetin e shpijnë në paaftësi, prapambeturi, dobësi, dhe e bëjnë të bie pre e armikut.

## Fusnotat:

1. “El-muvafekat”, 2/6, Shatibiju.
2. “Medasidu sheriati”, 51-55, Muhamed Dhahir bin Ashurë.
3. “El-muvafekatë”.  
“El-mustesfa”.  
“Sherhul Esnevij”.  
“Sherhul udadi alev muhtesar el muntehij”. 2/340.  
“Revdatu Nadhir”.  
“Fevatihu Rahmut”.  
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë”.  
“El-Ibhaxh”.  
“El-med-hal ila medhheb Ahmed”.  
“El-ihkam”.  
“Irshadul Fuhulë”.
4. Përdorimi i barërave për pengimin e shtatzënisë dhe metodat e tjera penguese të shtatzënisë - nuk do të thotë se nuk lejohet ndalimi i prostitucionit sepse ndalimi i prostitucionit nuk është vetëm për përzierjen e trashëgimtarëve, por ndalohet edhe për shkak të krijimit të urrëjtjes dhe armiqësisë. Po ashtu pajtueshmëria për prostitucion - nuk do të thotë se lejohet prostitucioni sepse prostitucioni shkakton sëmundje ngjitëse dhe është sulm ndaj nderit, e cila ndikon në devalvimin e familjes dhe trashëgimtarëve.
5. “El-muvafekatë”, 2/12-16.
6. “El-muvafekatë”, 2/16-25.
7. “Mekasidu Sheriati”, 86, Ibni Ashurë.
8. “Mekasidu Sheriati”, 86, Ibni Ashurë.
9. Transmeton Ahmedi dhe gjashtë koleksionistët nga Ebu Bekri, në formulimin: **Le të mos gjykoj gjykatësi ndërmjet dy palëve përderisa është i hidhëruar.** Po ashtu në formulimin “le të mos gjykoj”, po ashtu në formulimin “le të mos ndaj drejtësi”. (“Nejlul evtarë”, 8/272).



## Përmbajtja:

<i>E para: Definicioni i objektivave të shariatit dhe rëndësia e saj dhe ndërtimi i shariatit mbi parimin e interesit.....</i>	<i>5</i>
<i>E dyta: Kushtet të cilat burojnë nga opinionet (e dijetarëve).....</i>	<i>9</i>
<i>E treta: Llojet e interesave varësisht prej ndikimit të tyre në shoqëri .....</i>	<i>11</i>
<i>Cilat janë llojet e interesave? .....</i>	<i>11</i>
1. Domosdoshmëritë .....	12
2. Nevojat .....	15
3. Plotësimet apo komoditetet.....	16
4. Plotësimi i interesave të mëparshme .....	17
<i>Renditja e objektivave.....</i>	<i>20</i>